

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Ardian Ajvazi dhe procesmbajtësen Valmira Sejdiu, në çështjen juridike, sipas padisë së paditësit [REDAKTUAR], me seli në Prishtinë, të cilin me autorizim e përfaqëson [REDAKTUAR] e kundër të paditurit [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR], Komuna e Ferizajt, për shkak të rimbursimit të dëmit, në seancën e mbajtur me datë 10.12.2015, në prezencën e të autorizuarit të paditëses, merr këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET në tërësi si e bazuar, kërkesëpadia e paditëses [REDAKTUAR] me seli në Prishtinë dhe DETYROHET i padituri S [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna e Ferizajt, që paditëses t'ia kompenzoj shumën prej 1,929.00 Euro (njëmijë e nëntëqindë e njëzet e nënte Euro), në emër rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 15.08.2010 në Ferizaj, me kamatë e cila do të llogaritet sipas lartësisë që llogarisin bankat për deponimet e rëndomta të qytetarëve, të afatizuara për periudhë një vjeqare pa destinim të caktuar, duke filluar nga data e parashtrimit të padisë 09.11.2013 e deri në pagesë definitive, si dhe taskën gjyqësore në shumën prej 40.00 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të këtij Aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Paditësja përmes të autorizuarit të saj ka parashtruar padi më datë 09.12.2013 për rimbursimin e dëmit kundër të paditurit [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR], Komuna e Ferizajt, për shkak se i padituri me datë 15.08.2010 në ora 22:30 me automjetin Motoçiklet Yamaha ka shkaktuar aksident trafiku në Ferizaj. I padituri në momentin e shkaktimit të aksidentit nuk ka qenë i siguar. I dëmtuar në këtë aksident ka qenë [REDAKTUAR] nga Ferizaj, i cili ka bërë kërkesë për kompenzim, andaj komisioni për vlerësimin e dëmeve ka marrë vendim nr.1963/2011 që të dëmtuarit në këtë aksident ti paguhet shpërblimi i dëmit në shumën prej 1,929.00 Euro. Përfaqësuesi i paditëses i ka propozuar Gjykatës që pas administrimit të provave të aprovon padinë dhe kërkesën e saj në tërësi si të bazuar si dhe i ka këkruar shpenzimet e procedurës civile.

I padituri nuk ka përgjigje në padi në shkrsat e lëndës si dhe nuk ka prezentuar në seancën për shqyrtim kryesor edhe pse është ftuar me rregull përmes fletkthesës së datës 14.11.2015 dhe mungesën nuk e ka arsyetuar.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes së fakteve të çështjes, për atë që palët ndërgjyqëse përmbushin detyrimin e tyre për t'i parashtruar ato, në kuptim të nenit 7.1 të LPK-së, Gjykata ka njerr dhe administruar një sër provash dhe atë:

Kërkesa për kompensim të dëmit të parashtruar nga ana e [REDAKTUAR] në [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] e datës 08.12.2010; kallzimi penal i datës 15.08.2010, me të cilin është akuzuar pala e paditur në këtë procedurë [REDAKTUAR], Raporti i policit hetues i datës 15.08.2010, raporti i policisë dhe skica e aksidentit, fletë lëshimi me ekspertizë për qëndrim në klinikë nga data 16.08.2010 deri me datë 20.08.2010 për të dëmtuarin [REDAKTUAR] Raporti i Spitalit në Ferizaj i datës 21.08.2010; raportet mjekësor të datave 14.09.2010; 11.10.2010; 19.10.2010; 07.12.2010; 30.08.2010, me anë të së cilëve kontstatohet fakti i lëndimeve të të dëmtuarit [REDAKTUAR]; ekspertiza e datës 10.12.2010, 7 fotografi dhe shkresa e datës 15.12.2010; Ujdia jashtë gjyqësore e datës 10.03.2011, me anë të së cilës BKS i ka kompensuar të dëmtuarin [REDAKTUAR] shumën prej 1,929.00 Euro; Vendimi i fondit të garancisë i datës 23.01.2011, me anë të së cilit Gjykata e vërtetoi faktin se paditësja ia ka aprovuar shumën e pretenduar në padi palës së dëmtuar në aksidentin e datës 15.08.2010; Urdhërtransferi i datës 10.03.2011, me anë të së cilit është urdhëruar transferi i shumës së pretenduar nga ana e paditëses; Transeri nga kontoja me numër [REDAKTUAR], me anë të së cilës konstatohet fakti se paditësja të dëmtuarit në aksidentin e datës 15.08.2010, ia ka kompensuar dëmin në shumën prej 1,929.00 avokatit të tij [REDAKTUAR] nga Ferizaj, në emër të [REDAKTUAR] Autorizimi i datës 07.12.2012, me anë të së cilit shihet se avokati [REDAKTUAR] ka qenë i autorizuar nga ana e [REDAKTUAR] për përfaqësim dhe tërheqjen e mjeteve nga [REDAKTUAR]

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve dhe provave të lartë cekura, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se padia e paditëses është në tërësi e bazuar.

Pas vlerësimit dhe administrimit të provave dhe pohimeve të pales paditëse, Gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

- Se i padituri ka qenë i pasiguruar dhe nga pakujdesia e ka shkaktuar aksidentin e komunikacionit të datës 15.08.2010 në Ferizaj;
- Se paditësja e ka kompensuar të dëmtuarin në këtë aksident [REDAKTUAR] shumën prej 1,929.00 Euro;
- Se ekziston baza juridike për përgjegjësi e të paditurit për rimbursim të dëmit material palës paditëse.

Nga faktet e treguara në padinë e paditëses si dhe nga provat dhe shkresat që gjenden në lëndë, rezulton si e themelt në tërësi kërkesëpadia, se gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë

kundërshti në mes provave të propozuara dhe fakteve të parashtruara nga paditësja. Gjykata vërtetoi se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për të vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

E drejta e rimbursimit të dëmit i takon paditëses ndaj debitorit kryesor, në këtë rast është i padituri për arsye se ai e ka shkaktuar aksidentin e komunikacionit, dhe nga paditësja është kompensuar pala e tretë [REDACTED]. Është e drejtë e garatuesit, kompensuesit të dëmit që të kërkojë realizimin e kërkesës ndaj debitorit kryesor.

Në nenin 208 të Ligjit mbi Marrëdhënjet Detyrimore të vitit 1978, parashihet se “*Debitori solidar që paguan më tepër nga sa është shuma e pjesës së tij në dëmin e krijuar, mund të kërkojë prej secilit nga debitorët e tjerë që t’ia kompensojë atë që ka paguar për të*”.

Në nenin 154 të Ligjit mbi Marrëdhënjet Detyrimore të vitit 1978, parashihet “*Kush i shkaktton tjetrit dëmin ka për detyrë ta kompensojë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij. Për dëmin nga sendet ose nga veprimtaritë, nga të cilat rrjedh rreziku i shtuar i dëmi për ambientin përgjigjet pavarësisht nga faji. Për dëmin pavarësisht nga faji përgjigjet edhe në raste të tjera të parashikuara me ligj*”.

Meqenëse paditësja ka në bazueshmërinë në tërsi kërkesëpadinë e saj, Gjykata në kuptim të nenit 452.1 të LPK-së, ka detyruar të paditurin që ta paguaj taksën gjyqësore për parashtrimin e padisë në shumën prej 20 Euro dhe për përpilimin e këtij Aktgjykimi shumën prej 20 Euro.

Nga të cekurat e mëlartë e duke u bazuar në nenin 143 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ
C.nr.712/13, me datë 10.12.2015

Gjyqtari,
Ardian Ajvazi

Këshilla Juridike: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të kopjes së tij, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, e të dorëzohet përmes kësaj Gjykate. Afati fillon nga dita e nesërme pas pranimit të këtij Aktgjykimi.

